

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 3072 Prot.

Tiranë, më 17.04.2015

Miratohet

LINDITA NIKOLLA

MINISTRI



RREGULLORE

E KONKURSIT PËR TEKSTE SHKOLLORE TË REJA

Në mbështetje të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, dhe të Udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11/1, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve të reja shkollore për vitin shkollor 2015-2016”, ministri i Arsimit dhe Sportit miraton rregulloren për tekstet shkollore të, si më poshtë vijon.

Neni 1

Qëllimi

Rregullorja përcakton mënyrën e organizimit të konkursit për tekstet shkollore të reja, kriteret dhe procedurat për realizimin e tij.

Neni 2

Tekste shkollore të reja

Tekstet shkollore të reja janë tekstet e përcaktuara në Udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11/1, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve të reja shkollore për vitin shkollor 2015-2016”.

Neni 3

Kërkesat dhe afatet kohore

Kërkesat për tekstet shkollore të reja dhe datat e zhvillimit të konkursit përcaktohen në Udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11/1, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve të reja shkollore për vitin shkollor 2015-2016”.

Neni 4

Pjesëmarrja në konkurs

1. Çdo shtëpi botuese dhe/ose distributor ka të drejtë të marrë pjesë në konkursin për tekstet shkollore të reja, nëse ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Nuk pranohet pjesëmarrja në konkurs e shtëpive botuese dhe/ose distributorëve që kanë shkelur kontratën e nënshkruar me MASH/MAS-in.
3. Shpenzimet e konkursit përballohen nga konkurruesi.

Neni 5

Hartimi i teksteve shkollore të reja

Hartimi i teksteve shkollore të reja bëhet në përputhje me Udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11/1, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve të reja shkollore për vitin shkollor 2015-2016” dhe me “Standarde për tekstet shkollore”.

Neni 6

Fazat e zhvillimit të konkursit

Konkursi për tekstet shkollore të reja zhvillohet në tri faza:

- a) Pranimi i dokumenteve dhe i teksteve shkollore të reja për konkurrim.
- b) Vlerësimi i teksteve shkollore të reja.
- c) Renditja e teksteve shkollore të reja për lëndë/klasë.

Neni 7

Pranimi i dokumenteve dhe i teksteve shkollore të reja për konkurrim

A. Për pjesëmarrjen në konkurs, botuesi dhe/ose distributori dorëzon:

A.1. Dokumentet e mëposhtme, origjinale ose të noterizuara, të futura në zarf:

- a) Ekstraktin historik nga QKR për regjistrimin si person juridik, me të drejtë ushtrimi aktiviteti si shtëpi botuese dhe/ose distributor;
- b) Certifikatën e regjistrimit në organet tatimore për ushtrimin e veprimtarisë tregtare;
- c) Vërtetimin nga gjykata dhe vërtetimin nga prokuroria që shtëpia botuese dhe/ose distributori dhe administratori që aplikon në emër të saj, nuk janë në ndjekje penale.

- d) Vërtetimin nga Drejtoria e Tatimeve dhe e Taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.

A.2. Për çdo titull teksti shkollor, në zarf të bardhë, me format A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme dalluese që mund të zbulojnë përkatësinë e zarfit, këto dokumente:

- a) Deklaratë e botuesit dhe e autorëve të teksteve shkollore të reja, që nuk janë në konflikt interesi, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.
- b) Deklaratë e të drejtave të autorit, mbi origjinalitetin e veprës në tërësi dhe pjesëve të saj, si dhe kopje të akteve ose të marrëveshjeve që mund të jenë bërë për aplikimin, për marrjen e lejes ose blerjen e elementeve të veçanta të drejtës së autorit nga të tretët, sipas shtojcës 2.
- c) Kontrata ndërmjet botuesit dhe autorit/ëve.
- d) Deklarata për çmimin e tekstit shkollor, sipas shtojcës 3.
- e) Të dhëna për autorin/ët e tekstit shkollor sipas shtojcës 4.
- f) Të dhëna për ekipin realizues të tekstit shkollor: redaktorin shkencor, redaktorin letrar etj. sipas shtojcës 5.

A.3. Tri kopje të tekstit shkollor të ri. Çdo kopje e tekstit shkollor të paraqitur për konkurrin të jetë e lidhur me vrima e me kapëse plastike me ngjyrë të zezë, pa përdorur ballinat (kopertinat) dhe faqet që mundet të identifikojnë përkatësinë e tekstit shkollor. Tri kopjet e tekstit, që paraqitet në konkurs, të dorëzohen në pako me ngjyrë të bardhë. Asnjë prej kopjeve të paraqitura për konkurrin të mos përmbajë shenjat e zakonshme të identifikimit (kopertinën, autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese etj.), që do të ketë teksti kur të jetë gati për përdorim. Botuesi paraqet aq pako, sa numri i titujve të teksteve shkollore për lëndë/klasë, që ai paraqet në konkurs. Mbi çdo pako, botuesi shkruan vetëm titullin e tekstit shkollor. Titulli i tekstit, në kopjet e dorëzuara, vendoset sipas emërimit në listën e publikuar në Udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve të reja shkollore për vitin shkollor 2015-2016”, jo i stilizuar sipas karakterit të linjës që ka ndjekur shtëpia botuese apo autorët e tekstit. Titulli të shkruhet me ngjyrë të zezë në llojin e letrës së bllokut të librit, me germa të mëdha shtypi, tip “Bookman Old Style”, bold, me madhësi 36-she. Në rastet kur verifikohen shkelje, teksti shkollor përjashtohet nga konkursi.

B. Marrësi në dorëzim, verifikon në prani të dorëzuesit, përmbushjen e kërkesave a, b, c, d të pikës A.1, të këtij neni. Mungesa, qoftë dhe e njërit prej dokumenteve të përcaktuara me sipër, sjell mospranimin në konkurs të botuesit dhe/ose distributorit. Në rast pranimit të dokumenteve, marrësi dorëzon një nga dy kopjet e formularit të përgatitur për marrjen në dorëzim.

C. Dokumentet e dorëzuara për konkurrin nuk kthehen.

Neni 8

Kodifikimi i dokumentacionit dhe i teksteve shkollore të reja

1. Marrësi në dorëzim kodifikon dokumentet dhe tekstet shkollore të reja, sipas përcaktimeve të Rregullores së KVTSh-së dhe përgjigjet ligjërisht për ruajtjen e fshehtësisë së kodifikimit.
2. Marrësi i dorëzon KVTSh-së tekstet shkollore të koduara, që do të vlerësohen nga recensuesit, sipas vendimit të KVTSh-së.

Neni 9

Vlerësimi i teksteve shkollore të reja

1. KVTSh, duke respektuar anonimatën e botuesit dhe/ose distributorit, u dorëzon recensuesve tekstet shkollore të reja për lëndë/klasë.
2. Recensuesit:
 - a) Studiojnë me hollësi çdo tekst shkollor të ri (përfshirë udhëzuesin për mësues dhe materialet shtesë, nëse ka të tilla).
 - b) Vlerësojnë tekstet shkollore, në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, duke caktuar vlerat e treguesve të çdo standardi (me simbolin **X** në kutinë përkatëse) dhe, për çdo standard, nëse duhet, plotësojnë një formular me rubrikat “Vërejtje” dhe “Sugjerime për përmirësim”, bazuar në vlerat e treguesve.
 - c) Llogaritin për secilin standard, vlerën e tij, sipas formulës përkatëse.
 - d) Plotësojnë me fjalë formularin përmbledhës (shtojca 1, në fund të dokumentit të STSh-ve) dhe rubrikat e tjera.
 - e) Në varësi të vlerësimit përmbledhës, grupojnë tekstet shkollore për lëndë/klasë që vlerësuan në dy kategori të mundshme: a) tekste që përmbushin STSh-të; b) tekste që nuk i përmbushin STSh-të.
 - f) I paraqesin me shkrim KVTSh-së vlerësimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.

Neni 10

Renditja e teksteve shkollore të reja për lëndë/klasë

1. KVTSh-ja, mbi bazën e vlerësimeve të recensentëve, nxjerr vlerën mesatare të standardeve për secilin tekst shkollor të ri për lëndë/klasë.
2. KVTSh-ja, bën renditjen e teksteve shkollore të reja për lëndë/klasë në përputhje me përcaktimet në “Standarde për tekstet shkollore”.

Neni 11

Shpallja e listës së teksteve shkollore të reja

MAS shpall listën e teksteve shkollore të reja. Lista e teksteve shkollore të reja publikohet në faqen zyrtare të MAS-it: www.arsimi.gov.al.

Neni 12

Konflikti i interesit

1. Punonjësit e MAS-it, e KVTSh-së dhe të institucioneve të varësisë, nuk mund të jenë autorë teksti, botues, pronarë shtypshkronje, që merr pjesë në procesin e hartimit të teksteve shkollore të reja.
2. Personat të cilët janë autorë tekstesh të katalogut të teksteve shkollore të vitit në vazhdim, nuk mund të jenë recensentë.

Neni 13

Detyrimet e shtëpive botuese/distributorëve

1. Shtëpia botuese/distributori merr përsipër dhe mban përgjegjësi për marrëdhëniet e saj me autorët e teksteve, për përgatitjen për shtyp të teksteve origjinale, për zbatimin e porosive për tekste nga MAS, për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve në shkolla.
2. Shtëpia botuese në kopertinën e çdo kopjeje të tekstit, duhet të shënojë çmimin, të vendosë barkodin dhe pullën me hologramën e certifikimit nga MAS, përpara nxjerrjes së tij në shitje.

Neni 14

Autorët e teksteve shkollore

1. Autorë të teksteve shkollore të reja do të quhen vetëm autorët e përmbajtjes së tekstit shkollor që përfshihet në katalog, ndërsa pjesëtarët e tjerë të ekipit realizues nuk do të cilësohen si autorë.
2. Autorët i rregullojnë marrëdhëniet me shtëpitë botuese nëpërmjet kontratave, që lidhin me to.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**SHTOJCA 1: DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Deklaroj se asnjë prej autorëve, recensuesve ose redaktorëve shkencorë dhe letrarë (emër, mbiemër, nënshkrim), të tekstit shkollor _____, dorëzuar për konkurrim në MAS, nuk është i lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të MAS-it dhe institucioneve të saj të varësisë.

Deklaroj, po ashtu, se Shtëpia Botuese _____ nuk është e lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të këtyre institucioneve.

Data _____

BOTUESI

Shënim

Dorëzohet një kopje me emrin, nënshkrimin dhe vulën e botuesit, në zarfin e bardhë A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme.

SHTOJCA 2: DEKLARATA PËR TË DREJTËN E BOTIMIT

Deklaroj se “ E drejta e botimit” e tekstit

_____, dorëzuar
për konkurs në MAS:

Pjesa e tekstit ose teksti në tërësi	Zotëruesi	Burimi
1. _____	_____	_____
2. _____	_____	_____
3. _____	_____	_____
4. _____	_____	_____
5. _____	_____	_____
6. _____	_____	_____
7. _____	_____	_____
8. _____	_____	_____
9. _____	_____	_____
10. _____	_____	_____

Data _____

BOTUESI

Shënim

1. Si pjesë të tekstit, për efekt të burimit të së drejtës së botimit, mund të përfshihen edhe ilustrime, ide, punë editoriale. Zotërimi i kësaj të drejte nga subjekti përkatës duhet të dëshmohet në kontratën përkatëse midis autorëve dhe botuesit ose me dokumente të blerjes apo dhurimit të kësaj të drejte nga të tretë, kopje të noterizuara të të cilave i bashkëlidhen kësaj deklarate. Në rastet kur e drejta e botimit është fryt i punës origjinale të vetë subjektit, në kolonën e tretë për burimin e të drejtës së botimit shënohet “Punë origjinale”. Në kolonën e burimit të drejtës së botimit shënohet, sipas rastit: “Origjinale”, ose “Nga të tretë” (shënohet në kllapa pala e tretë dhe përfshihet dokumenti i blerjes apo dhurimit).
2. Dorëzohet një kopje me emrin, nënshkrimin dhe vulën e botuesit, në zarfin e bardhë A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme.

SHTOJCA 3: DEKLARATËN PËR ÇMIMIN E TEKSTIT

Deklaroj se çmimi i shitjes së tekstit _____,
dorëzuar për konkurs në MAS, është _____ lekë.
(Me shifra dhe fjalë)

Data ____ . ____ . ____

BOTUESI

Shënim

Dorëzohet një kopje me emrin, nënshkrimin dhe vulën e botuesit, në zarfin e bardhë A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme.

SHTOJCA 4: TË DHËNA PËR AUTORËT E TEKSTEVE

Grupi i autorëve	Po	Jo
Autor i vetëm, pedagog	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Autor i vetëm, mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dy ose më shumë pedagogë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dy ose më shumë mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pedagog dhe mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Më shumë se dy mësues dhe pedagogë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Formimi universitar: (Titulli i diplomës që zotëron)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Diplomuar brenda vendit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Diplomuar jashtë vendit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Formimi pasuniversitar dhe titulli shkencor/ akademik:

Titulli	Brenda vendit	Jashtë vendit
Master	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Doktor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Profesor i Asociuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Profesor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Akademik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përvoja pedagogjike:

- Mësues i lëndës ____ vjet
- Pedagog i lëndës ____ vjet

Veprimtari botuese në 10 vitet e fundit:

- Numri i artikujve divulgativë si autor i parë ose i dytë: _____
- Numri i artikujve shkencorë si autor i parë ose i dytë: _____
- Numri i monografive: _____, Libra artistikë: _____, Vepra të tjera _____
(si autor i parë ose i dytë)
- Numri i teksteve mësimore, si autor i parë ose i dytë, për arsimin 9-vjeçar: _____
- Numri i teksteve mësimore, si autor i parë ose i dytë, për arsimin e mesëm: _____
- Numri i teksteve mësimore, si autor i parë ose bashkautor, për arsimin e lartë: _____

DEKLARATË PËR AUTORËSINË E TEKSTIT

Deklaroj se autorët e tekstit _____, dorëzuar për konkurs në MAS, janë:

Emri	Pjesa e tekstit (kapitujt ose thjesht bashkautorësi)
1.	
2.	
3.	
4.	

Data ____ . ____ . ____

BOTUESI

Shënim

Dorëzohet një kopje me emrin, nënshkrimin dhe vulën e botuesit, në zarfën e bardhë A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme.

SHTOJCA 5: TË DHËNA PËR REDAKTORËT SHKENCORË DHE REDAKTORËT LETRARË

1. Për redaktorët shkencorë

a) Redaktori i parë

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
	Punëdhënësi _____

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka)

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
	Punëdhënësi _____

2. Për redaktorët letrarë

a) Redaktori i parë

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
	Punëdhënësi _____

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka)

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
	Punëdhënësi _____

Shënim

Dorëzohet një kopje me emrin, nënshkrimin dhe vulën e botuesit, në zarfin e bardhë A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme.